

Hidromorava  
Gjilan

KOMPANIA RAJONALE  
E UJËSJELLËSIT  
**HIDROMORAVA Sh.a.**

No. 71 Data 31.01.2023  
GJILAN



|                                                                        |          |
|------------------------------------------------------------------------|----------|
| REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA /<br>REPUBLIC OF KOSOVO         |          |
| QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT                                           |          |
| MINISTRIA E EKONOMISE<br>MINISTARSTVO EKONOMIJE<br>MINISTRY OF ECONOMY |          |
| Njesia Org.<br>Org. Jedin<br>Org. Unit                                 | 01/3     |
| Nr. i faqeve<br>Broj stranica<br>No. pages                             | 32       |
| Nr. Prof.<br>Br. Prof.<br>Prof.No.                                     | 390      |
| Dati:<br>Datum:<br>Date:                                               | 31.01.23 |
| PRISTINE/A                                                             |          |
| NO.1                                                                   |          |

## KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "HIDROMORAVA" SH.A GJILAN



## PLANI I BIZNESIT 2023-2025

## PËRMBAJTJA

|                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Përmbledhje                                                   |    |
| 1.1 Historiku i kompanisë KRU Hidromorava.....                   | 3  |
| 1.2 Misioni i kompanisë .....                                    | 4  |
| 1.3 Risku i kompanisë .....                                      | 4  |
| 2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË KOMPANISË.....                      | 5  |
| 2.1 Performanca nga viti 2022 deri 2024.....                     | 5  |
| 2.2 Objektivat e punës .....                                     | 7  |
| 3. DEKLARATA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT .....                       | 8  |
| 4. PLANI I MENAXHIMIT TË ASTEVE                                  |    |
| 5. GJENDJA AKTUALE E PERSONELIT .....                            | 9  |
| 9                                                                |    |
| 5.1 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit .....           | 10 |
| 5.2 Politika e pagesës ( përfitimet , pagesat nxitëse etj )..... | 10 |
| 5.3 Programet e Rekrutimit.....                                  | 10 |
| 6. DEPARTAMENTI TEKNIK .....                                     | 13 |
| 5.1 Shfrytëzimi i kapaciteteve prodhuese .....                   | 13 |
| 5.2 Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit .....                   | 16 |
| 7. SHËRBIMI ME KONSUMATORE .....                                 | 19 |
| 7.1 Zgjerimi i zonës së shërbimit.....                           | 20 |
| 7.2 Gatishmëria për të paguar .....                              | 20 |
| 8. PLANI FINANCIAR .....                                         | 21 |
| 7.1 Plani i financimit kapital .....                             | 21 |
| 7.2 Kërkesat vjetore operative dhe të hyrat kapitale .....       | 21 |
| 9. PLANI KOMERCIAL .....                                         | 22 |
| 9.1 Politikat dhe programet e Matjes.....                        | 22 |
| 9.2 Evitimi i lidhjeve ilegale /fiktive /pasive .....            | 23 |
| 9.3 Përmirësimi i faturimit të bazës së konsumatorëve... ..      | 23 |
| 10. PLANI IINVESTIMEVE KAPITALE : 2023-2025.....                 | 25 |

## Përmbledhje

Plani i Biznesit 2023-2025 ofron një pasqyrë për të siguruar një performancë për shërbime me furnizim me ujë duke identifikuar ndikimet e jashtme dhe të brendshme që i nënshtrohen industrisë së ujit, aktivitetet e nevojshme për të siguruar që ajo të përmbushë objektivat e ndërmarrjes në mënyrë të matur dhe efikase.

Në zhvillimin e planit të biznesit rëndësi i kushtohet edhe ndikuesëve të jashtëm si legjislacioni ekonomik e social, ndikimet mjedisore, struktura organizative, qeverisja dhe menaxhimi i riskut.

Objektivat e Kompanisë na sigurojnë të fokusohemi në shërbimin sa më të mirë duke ndërtuar strategji dhe identifikuar indikatorët kyq për një arritje drejt realizimit të qasës dhe përmbushjes së planifikimit.

Plani i performancës konsideron burimet njerëzore si një komponent themelor në realizimin e objektivave të saj, siguron një strukturë të përgjithshme të menaxhimit, menaxhimin strategjik të aseteve, përgjegjësitë e programeve të shërbimeve të ujit dhe trajtimit. Dy iniciativa të identifikuara në plan janë për të harmonizuar aktivitetet e stafit dhe rezultatet e dakorduara për struktura të re organizative.


Objektivat financiare përfshijnë uljen e kostos së ofrimit të shërbimeve duke ofruar efikasitet operacional. Plani ofron një përmbledhje të menaxhimit financiar të biznesit për vitet financiar 2023-2025, duke përfshirë çmimet dhe të ardhurat e parashikuara, shpenzimet kapitale, performancën e buxhetuar dhe shpenzimet operative. Në bazë të iniciativave dhe aktivitetëve aktualë, ndërmarrja parashikon të arrijë arkëtim nga shitja e ujit në vlerë prej 2,388 mil euro, parashikon që shpenzimet operative të janë rreth 1,872 mil euro, dhe investime kapitale në vlerë prej 408 mijë euro të cilat janë të përcaktuara nga Autoriteti Rregullator për ujëra si: përtëritje të infrastrukturës, rritje e infrastrukturës dhe mirëmbajtje kapitale të jo-infrastrukturës dhe pjesën tjetër të mjeteve prej 108 mijë euro në investime të tjera krahas nevojave të kompanisë.

Iniciativat kryesore që do të jepen gjatë planit tre vjeçarë të biznesit janë të detajuara në vazhdim, të cilat synojnë të sigurojnë që shërbimet me ujë të përmbushin objektivat e ndërmarrjes në të ardhmen.

Gjatë periudhës 2023 do të vazhdohet me ngritjen normës së faturimit të bazuar në lexim të ujëmatësve deri në 100%, do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për konsumatorët jo-ekzistent.

### 1.1. Historiku i kompanisë KRU Hidromorava

Furnizimi me ujë të pijshëm i qytetit të Gjilanit nga ujësjellësi publik, fillon aty kah viti 1940 me ndërtimin e kaptazhës së parë afër fshatit Koretishtë, e cila gjendet rreth 4 km nga qendra e sotme e qytetit të Gjilanit, me vazhdim të rekonstruimit, zgjerimit e modernizimit të vazhdueshëm. Në vitin 1971 filloi projekti për zgjerimin e kapaciteteve të ujit të pijshëm për qytetin e Gjilanit, në pjesën mbi fshatin Përlepnice, pikërisht në vendin e quajtur 'Guri i Hoxhës' e cila gjendet rreth 5 km nga fshati Përlepnice. Kështu që në vitin 1978 filloi realizimi i projektit më të rëndësishëm për furnizim me ujë të pijshëm duke ndërtuar pendën në fshatin Përlepnice, ku punimet kanë zgjatë deri në fund të vitit 1983 dhe krahas ndërtimit të pendës është ndërtuar edhe fabrika për pastrimin e ujit të pijshëm.



Pas përfundimit të luftës në fund të vitit 1999, komuniteti ndërkombëtar me sugjerimin dhe angazhimin e Qeverisë së Kosovës filluan procesin e riorganizimit të jetës në Kosovë e në këtë kontekst edhe organizimin e ndërmarrjeve publike duke i shëndërruar ato në kompani publike. Komuniteti ndërkombëtar dhe Qeveria e Kosovës, fillimisht studiuan gjendjet aktuale në të gjithë ujësjellësit e Kosovës, e pastaj në bashkëpunim me shumë partner ndërkombëtar filluan riorganizimin dhe rimëkëmbjen e tyre duke themeluar 7 (shtatë) kompani Rajonale të ujësjellësve dhe kanalizimit. Në procesin e rimëkëmbjes së Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" në Kosovën Juglindore, partner kryesor shtytës ka qenë Agjencia Zvicerane për Zhvillim – SDC (Sëiss Agency for Development)

### 1.2 Misioni i Kompanisë

Misioni i kompanisë është të sigurojë furnizim të qëndrueshëm me ujë e të sigurt, në sasi të mjaftueshme dhe me cilësi të duhur në përputhje me standardet në fuqi, për të gjithë konsumatorët e lidhur në sistem pa dallim race, gjinie dhe religjioni.

Të sigurojë shërbime cilësore të grumbullimit, trajtimit e shkarkimit të ujërave të ndotura , për të mbrojtur shëndetin publik dhe në përputhje me standardet e mbrojtjes së mjedisit.

Të përmirësojë në mënyrë të qëndrueshme performancën financiare të kompanisë, në mënyrë që të përparojë në drejtim të arritjes së qëndrueshmërisë së plotë financiare duke siguruar likuiditet financiar dhe për ta bërë atë të aftë të marrë kredi për investime kapitale.

### 1.3. Risqet e kompanisë

Zbatimi i misionit të Kompanisë mund të përcillet me rreziqet eventuale të natyrave të ndryshme si:

- mungesa e ujit në burime si pasojë e mungesës së reshjeve atmosferike
- kriza sociale-ekonomike në nivel të vendit ose lokal,
- zhvillimi i pandemive me ndikim në mosrealizimin e të ardhurave
- mosgatishmëria e donatorëve potencial në financimin e projekteve investive të nevojshme
- fatkeqësitë e papritura natyrore

## 2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË TË KOMPANISË

Kompania e cila përbëhet nga Qendra Regjionale në Gjilan dhe dy njësitë operative Viti dhe Kamenicë , funksionon me vendimmarrje dhe llogaridhënie Bordit të Drejtorëve dhe Njësisë për Politika Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike , në përputhshmëri me principet e qeverisjes kooperative . Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti i KRU Hidromorava Sh. A. ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike në vijim:

- a) Sigurimi i i burimeve të mjaftueshëm të ujit për Regjionin e Gjilanit
- b) Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale
- c) Rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit
- d) Vazhdimin e avancimit të sistemit informativ gjeografik (GIS) për të përfshirë tërë zonën e shërbimit dhe hartimin e Planit të Menaxhimit të Aseteve;
- e) Mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit;

- f) Adoptimin e plotë të Rregulloreve konfrom rekomandimeve të ARRU-së përfshirë atë të Standardeve Minimale të Shërbimeve, Licencimit , Kartën e Konsumatorëve , Politikën Tarifore të ARRU, dhe të tjera, për sigurimin cilësor të shërbimeve.
- g) Rritja e transparencës në raportimet të cilat i bënë Menaxhmenti i Kompanisë Bordit të Drejtorëve dhe palëve të treta të interesuara;
- h) Mbajtjen edhe më tutje të vetëqëndrueshmërisë financiare, përmes rritjes së normës së mbulesës së punës;
- i) Rritja e vlerës së aseteve për periudhën 2023-2025 varësisht prej realizimit të investimeve nga donatorët , qeveria dhe investimet vetanake;

Për realizimin e objektivave kryesore strategjike, për periudhën 2023-2025 kompania ka paraparë përmbushjen e treguesve në vijim të përcaktuara në kordinim me ARRU:

Tabela 1 Treguesit e performancës

| Treguesit Kryesorë Performancës    | Njësia] | 2021  | 2022   | 2023   | 2024   | 2025   |
|------------------------------------|---------|-------|--------|--------|--------|--------|
| Ujë i pafaturuar-si përqindje      | %       | 48.18 | 43.20  | 41.20  | 39.20  | 39.00  |
| Norma e arkëtimit - e përgjithshme | %       | 88.43 | 93.49  | 93.50  | 93.68  | 94.05  |
| Norma e arkëtimit – Amvisëritë     | %       | 87.00 | 92.00  | 92.00  | 92.00  | 93.00  |
| Norma e arkëtimit -Jo-Amvisëri     | %       | 96.50 | 100.00 | 100.00 | 100.00 | 100.00 |
| Norma e mbulesës së punës          | Numër   | 1.21  | 1.23   | 1.28   | 1.34   | 1.45   |
| Përqindja e konsumatorëve me lexim | %       | 99.40 | 99.70  | 99.99  | 100.00 | 100.00 |
| Staf për 1000 konsumatorë          | Numër   | 5.30  | 4.11   | 4.10?  | 4.05   | 4.00   |

## 2.1 Performanca nga viti 2021 , 2022 dhe parashikimi 2023, shprehur në 000'

Tabela 2 Performanca dhe parashikimi për 2023 ( shprehur në"000m3 ose "000 euro)

| Nr | Performancat e KRU "Hidromorava" SHA-Gjilan X1000 m3 dhe X1000€ | 2021   | 2022   | 2023   | Plani I rritjes në % |
|----|-----------------------------------------------------------------|--------|--------|--------|----------------------|
| 1  | Prodhim i ujit m3                                               | 7,700  | 7,702  | 7,855  | 1.99                 |
| 2  | Faturimi i ujit m3                                              | 3,979  | 4,379  | 4,622  | 5.54                 |
| 3  | Faturimi €                                                      | 2,254  | 2,455  | 2,588  | 5.42                 |
| 4  | Arkëtimi €                                                      | 1,985  | 2,297  | 2,388  | 3.96                 |
| 5  | Përqindja e arkëtimit (%)                                       | 88.43  | 93.49  | 93.20  | -0.31                |
| 6  | Shpenzimet €                                                    | 1,850  | 1,866  | 1,872  | 0.32                 |
| 7  | Konsumatorëve të regjistruar ( numër)                           | 38,300 | 39,000 | 42,080 | 7.89                 |
| 8  | Konsumatorë aktiv ( numër)                                      | 34,900 | 37,056 | 40,130 | 8.29                 |

|    |                                          |        |        |        |      |
|----|------------------------------------------|--------|--------|--------|------|
| 8  | Konsumatorë me UM (numër)                | 34,600 | 36,892 | 40,130 | 8.77 |
| 9  | Konsumatorë me UM( %)                    | 99.95  | 99.97  | 99.99  | 0.02 |
| 10 | Përqindja e ujit të faturuar             | 51.68  | 56.80  | 58.80  | 3.52 |
| 11 | Përqindja e ujit të pa faturuar (humbja) | 48.32  | 43.20  | 41.20  | 4.85 |
| 12 | Norma e mbulimit të punës(4/6)           | 1.02   | 1.23   | 1.28   | 4.06 |

Tabela 3 Performanca nëntë mujore krahas planifikimit, për vitin 2022 ( shprehur në"000m3 ose "000 euro)

| Nr | Performancat e KRU "Hidromorava" SHA-Gjilan X1000 m3 dhe X1000€ | Nëntë mujori i realizuar 2022 | Nëntë mujori i planifikuar 2022 | Realizimi i planit nëntë mujor 2022 |
|----|-----------------------------------------------------------------|-------------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|
| 1  | Prodhimi i ujit m3                                              | 5,751                         | 5,945                           | 96.74                               |
| 2  | Faturimi i ujit m3                                              | 3,079                         | 3,372                           | 91.31                               |
| 3  | Faturimi €                                                      | 1,735                         | 1,890                           | 91.80                               |
| 4  | Arkëtimi €                                                      | 1,630                         | 1,769                           | 92.14                               |
| 5  | Përqindja e arkëtimit( %)                                       | 93.95                         | 93.59                           | 100.38                              |
| 6  | Shpenzimet €                                                    | 1,316                         | 1,394                           | 105.92                              |
| 7  | Konsumatorëve të regjistruar( numër)                            | 39,156                        | 39,870                          | 98.21                               |
| 8  | Konsumatorë aktiv (numër)                                       | 35,530                        | 36,480                          | 97.40                               |
| 8  | Konsumatorëve me UM( numër)                                     | 35,348                        | 36,316                          | 97.33                               |
| 9  | Përqindja e konsumatorëve me UM                                 | 99.48                         | 99.50                           | 99.98                               |
| 10 | Përqindja e ujit të faturuar                                    | 53.50                         | 56.70                           | 94.36                               |
| 11 | Uji i pa faturuar (humbja)                                      | 46.50                         | 43.30                           | 93.11                               |
| 12 | Norma e mbulimit të punës( 4/6)                                 | 1.07                          | 1.26                            | 84.92                               |

#### Masat për realizimin e objektivave

Sa i përket objektivës së parë – sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit, Kompania nuk ka mundësi as financiare as njerëzore të realizoj këtë objektivë. Për arritjen e këtij qëllimi Kompania do të mbështetet nga burimet e jashtme qofshin ato qeveritare apo kontributi i donatorëve . Në këtë drejtim është duke u punuar në dy drejtime:

- Projekti i akumiulimit të ujit në lumin Lepenc, i financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe
- Projekti FLOËS, i financuar nga Banka Botërore ku parashihet të bëhet edhe studimi i fizibilitetit edhe per Regjione te tjera per gjetjen e burimeve të tjera të ujit.
- Projekti i akumiulimit të ujit në lumin Lipushnica, dhe transportimi i ujit deri ne Impiantin e trajtimit të ujit në Perlepnice.
- Projekti i akumiulimit të ujit në lumin Morava e Binçes ne lokacionin Shusht në Viti,

**Objektiva e dytë – zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit-**

Humbjet e ujit janë indikatorë kyç për Kompaninë. sfidë na mbetet viti 2023 për të arritur cakun e UPF-së në 41.20 e cila normë është përcaktuar nga Autoriteti Rregullativ për ujëra.

Duhet të angazhohemi rreth identifikimit të lidhjeve të pa autorizuara , keqpërdorimeve , vendosja e ujëmatësve zonal dhe duhet marrë masat e tjera të përcaktuara konform rregulloreve të Autoritetit Rregullator për ujëra.

Kjo objektivë do të arrihet me masat në vijim:

- Ndërrimi i gypave kryesor të ujësjellësit që është pjesë e projektit FLOËS. Vendosja e këtyre gypave do të ndikoj dukshëm në zvogëlimin e humbjeve, para së gjithash atyre teknike, por edhe do të eliminoj shumë lidhje ilegale të cilat supozohet se ekzistojnë në këta gypa.
- Vendosja e matësve zonal dhe shtimi i përpjekjeve për zbulimin e lidhjeve ilegale. Në periudhën 2023-2024 do të krijohen DMA me një numër të konsiderueshëm kosnumtorësh
- Inspektimi /detektimi i kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit
- Shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht
- Instalimi i ujëmatësve zonal për zbulimin e humbjeve të ujit
- Kalibrimi i ujëmatësve
- Inspektimi i rregulltë dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional
- Ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve dhe kompenzimi i demit të shkaktuar konform Rregullores së ARRU-së , etj
- Riparimi i rrjedhjeve sipërfaqësore dhe identifikimi i rrjedhjeve nëntokësore

**Objektiva e tretë – rritja e shkallës së faturimit dhe arkëtimit, do të arrihet me masat në vijim:**

- Plani i arkëtimit për vitin 2023 është 93.20%. Këtë normë duhet ta arrijmë me angazhimin e të gjithëve e sidomos me stafin e ekipit për shkyçje të konsumatorëve që nuk i kryejnë obligimet për ujin e shpenzuar, dhe sigurisht që do t'i përdorim metoda të ndryshme rreth organizimit të arkëtimit të mjeteve.
- Kompania do të jetë në vazhdimësi e detyruar që të aplikoj masa më të ashpra për ti detyruar konsumatorët ti bëjnë pagesat e tyre.
- Problem për mos pagese të ujit të harxhuar do të ketë nga kategoritë e konsumatorëve shtëpiak-amvisëritë, bizneset e vogla dhe institucione.
- Përqindje jo e kënaqshme e inkasimit tek kategoria e konsumatorëve-shtëpiak është gjendja ekonomike si pasoje e rritjes së kostos së jetesës nga kriza ekonomike.
- Kompania në vazhdimësi inkurajon dhe mbështet idetë dhe politikat të cilat ndihmojnë në përmirësimin e shkallës së arkëtimit.

**Tabela 4**

**Planifikimi i performancës operative për vitin 2023**

| Treguesit Operativ          | PI Biznesi 2023 |
|-----------------------------|-----------------|
| Prodhimi i ujit në m3       | 7,854,741       |
| Faturimi i ujit (%)         | 58.80           |
| Arkëtimi i ujit (%)         | 93.20           |
| Uji i pafaturuar (%)        | 41.20           |
| Testet e dështuara (%)      | 0               |
| Konsumatorë me Ujëmatës (%) | 100.00          |
| Numri i konsumatorëve       | 39,071          |
| Numri i punëtorve           | 169?            |

### 3. TARIFAT E SHËRBIMIT

Kompania Rajonale e Ujësjesit Hidromorava Sh. A zbaton tarifën që vendos Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit (ARRU). Në bazë të tarifave /çmimeve aktuale , duke marrë në konsideratë prodhimin, shkallën e arkëtimit , nivelin e humbjeve komerciale dhe teknike mund bëhet në tërësi mbulimi i kostove operative por me shume vështirësi nëse nuk përmirësohen resurset ujore që aktualisht në fund të tremujorit të tretë niveli ka shënuar rënie deri në 17 m , andaj duke marrë parasysh gjendjen aktuale e cila ndikon në rënie të shitjes edhe financimi i investimeve kapitale në atë shkallë sa është përckatuar nga procesi tarifar mund të mos përmbushet.

Tabela 5 – Tarifat

|                                                       |               | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|-------------------------------------------------------|---------------|------|------|------|------|
| <b>Ujë</b>                                            |               |      |      |      |      |
| Shtëpiak - tarifa fikse mujore                        | EUR/kons/muaj | 1    | 1    | 1    | 1    |
| Shtëpiak -volumetrike                                 | EUR/m3        | 0.34 | 0.35 | 0.35 | 0.35 |
| Komercial-industrial-tarifa fikse mujore              | EUR/kons/muaj | 2    | 2    | 2    | 2    |
| Komercial-industrial-volumetrike                      | EUR/m3        | 0.54 | 0.52 | 0.52 | 0.52 |
| Institucional- tarifa fikse mujore                    | EUR/kons/muaj | 2    | 2    | 2    | 2    |
| Institucional-volumetrike                             | EUR/m3        | 0.54 | 0.52 | 0.52 | 0.52 |
| <b>Ujërat e ndotura (vëllimi i ujit të konsumuar)</b> |               |      |      |      |      |
| Shtëpiak                                              | EUR/m3        | 0.08 | 0.08 | 0.08 | 0.08 |
| Komercial-industrial                                  | EUR/m3        | 0.17 | 0.17 | 0.17 | 0.17 |
| Institucional                                         | EUR/m3        | 0.17 | 0.17 | 0.17 | 0.17 |
| <b>Tarifat kumulative</b>                             |               |      |      |      |      |
| Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)                   | EUR/m3        | 0.42 | 0.43 | 0.43 | 0.43 |
| Jo-shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)                | EUR/m3        | 0.71 | 0.69 | 0.69 | 0.69 |

### 4 PLANI I MENAXHIMIT TË ASETEVE


Plani për menaxhimin e aseteve (PMA) përfshin vlerësimin e mbi 200 aseteve mbi tokësore nga kategoritë e Strukturave Ndërtimore si Ndërtesat e Stacioneve e Pompimit, Rezervuareve, Pompat, Valvolat, Veturat, Pajisjet Elektike dhe pjesë tjera më të imta. Sipas kronologjisë së zhvillimeve në këtë drejtim, dokumenti i iniciuar (PMA) nga ARRU i paraprin projektin i cili është duke ndodhur i Menaxhimit të Integruar të aseteve (MIA) në platformën – softëerin EDAMS dhe i cili mund të vazhdohet me aprovimin e fazës së tretë – Platin e cila në fund do të merret ndër të tjera tema edhe me Menaxhimin e aseteve si tema kryesore. Iniciativa nga ARRU që të mos pritët përfundimi i në EDAMS por që të vlerësohen së paku ato asete të cilat janë të dukshme dhe mund të vizitohen me qëllim që të mos ketë vonesa në fillimin e këtij procesi. Zyra e menaxhimit të aseteve ka pasur dokumentin e parë dhe

aplikacionin e parë që në vitin 2016, ku është përdorë metodologjia e praktikave më të mira botërore. Momentalisht Asetet janë vlerësuar në 4 kategori ku janë përcaktuar Shërbyeshmëria dhe kritikaliteti (gjendja kritike e asetit) dhe në fund është bërë radhitja e aseteve më kritike. Kjo listë njëherit duhet të jetë edhe lista prioritare për të bërë planin e investimeve. Ky dokument duhet të jetë udhërrëfyes për Planin e Biznesit.

Lista e dalë nga kjo pjesë e vlerësimit është paraqitur më poshtë me ndihmën e aplikacionit:

Grafikoni

## 10 Top Asetet Kritike



### 5.5. Gjendja aktuale e personelit

Aktualisht KRU "Hidromorava" Sh.A. operon me 150 punëtorë, 117 në Gjilan, 17 në Viti dhe 16 në Kamenicë, të ndarë në tre departamente: Departamenti Teknik, Financiar dhe Departamenti i Administratës.

KRU "Hidromorava" Sh.A. ka këtë strukturë të punësuarve:

Tabela 6 Gjendja aktuale e personelit

Kualifikimi i stafit të KRU  
Nr. "Hidromorava" ShA Gjilan

|                                                        | Gjilan     | Viti      | Kamenicë  | Totali     |
|--------------------------------------------------------|------------|-----------|-----------|------------|
| <b>1 Master</b>                                        | <b>5</b>   | <b>-</b>  | <b>-</b>  | <b>5</b>   |
| <b>2 Me fakultet 3/4 vjeçar</b>                        | <b>20</b>  | <b>6</b>  | <b>4</b>  | <b>30</b>  |
| <b>4 Shkolla e mesme</b>                               | <b>69</b>  | <b>10</b> | <b>8</b>  | <b>87</b>  |
| <b>5 Punëtorë të kualifikuar</b>                       | <b>6</b>   | <b>-</b>  | <b>-</b>  | <b>6</b>   |
| <b>6 Punëtorë të pakualifikuar ( shkolla fillore )</b> | <b>17</b>  | <b>1</b>  | <b>4</b>  | <b>22</b>  |
| <b>Totali</b>                                          | <b>117</b> | <b>17</b> | <b>16</b> | <b>150</b> |

### 5.1 Nivelet e aftësisë dhe programet e trajnimit

Riorganizimi i punës, transferimi i punëtorëve në shërbime të planifikuara, ndryshimet e vazhdueshme strukturore që kanë si synim fleksibilitet më të madh në punë dhe përshtatje me mjedisin e punës janë treguesit kryesor që trajnimi dhe zhvillimi stafit të jetë një proces i vazhdueshëm me ndikim pozitiv në rritjen e efikasitetit të KRU "Hidromorava" SH.A. Përmes këtij procesi synohet të arrihet një përmirësim i aftësive dhe një kualifikim profesional i punëtorëve, sepse çdo punë ka specifikat e veta.

KRU "Hidromorava"Sh. A në nivel të Kompanisë do të organizojë brenda sektorëve trajnime për punëtorët nga përgjegjësit e sektorëve dhe nga ana e drejtuesve të departamenteve në vazhdimësi.

Po kështu është menduar që të organizohen edhe trajnime në dimensionin e ngritjes së shërbimit financiar dhe atyre teknik në nivel të Shoqatës së Ujësjellësit dhe Kanalizimit të Kosovës siç janë organizuar edhe më parë. Nevojat e trajnimeve janë evidente si në menaxhment ashtu edhe në sektorët financiar, teknik, prokurim dhe administrativ..

Gjatë vitit 2023 do shikohet mundësia e organizimit të trajnimeve menaxheriale si p.sh menaxhimit modern të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar , GIS, mirëmbajtjen e rrjetit të furnizimit me ujë, reduktimin e humbjeve në rrjet, menaxhimit të sistemit informativ dhe trajnime tjera.

### 5.3 5.2 Programet e rekrutimit

Suksesi dhe përshtatshmëria e një kompanie ndër të tjera varet edhe nga rekrutimi i punonjësve , të cilët janë profesional , të nevojshëm dhe të përkushtuar në punë. Prandaj KRU Hidromorava"Sh.A. parasheh që për shkak të rritjes së numrit të konsumatorëve dhe vëllimit të punëve të bëjë rekrutimin e punonjësve të cilët janë të nevojshëm për sektorët e veçantë në kuadër të kompanisë.

Gjatë nëntëmuajt të parë menaxhmenti i kompanisë konsideron se resurset njerëzore nuk janë ende në nivelin e kërkuar sa i përket anës profesionale dhe këto aspekte të stafit do të adresohen gjatë viteve planifikuese 2023-2025, ku sidomos në departamentin e financave kërkohet plotësimi i dy pozitave bazuar në Ligjin mbi Financat Publike , dhe njëkohësisht të cilat janë të domosdoshme të plotësojnë kriteret për implementimin e projekteve në tre vitet e ardhshme siq janë FLOËS dhe Impianti për Trajtimin e UjëraveN

Kompania aktualisht ka normen 4.22 per 1,000 konsumatorë . Deri në fund të vitit 2022 menaxhmenti i kompanisë parasheh ndryshime në strukturën organizative duke i dhënë rëndësi më të madhe

kontrollës në teren, leximit të ujëmatësve, si dhe forcimit të sektorit të shkyqjes si mjet për rritjen e arkëtimit dhe të të ardhurave të Ndërmarrjes.

Hapat që priten të ndërmerren që nga fillimi i vitit 2023 për kompaninë janë:

1. Ndërprerja e pagesës me para në dorë nga konsumatorët në zonë urbane përmes inkasanteve, lëvizja e inkasanteve në sektor të tjerë brenda kompanisë siq i parashohin nevojat e Kompanisë për ndryshime me qëllim të rritjes së efikasitetit më të lartë në lexim të ujëmatësve, shkyqje, dhe inspektim.
2. Ndarja e sektorit të shitjes si departament nga departamenti i financave i cili do të merret ekskluzivisht me performancën e kompanisë (shërbimi ndaj konsumatorëve, leximi i ujëmatësve, faturimi, inspektimi)
3. Zyra e shkyqjes do të kalojë në kuadër të departamentit teknik për shkak të koordinimit me të mirë me ekipet e rrjetit të mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të kapaciteteve brenda këtij departamenti.
4. Përgaditja e planit për ristrukturim.


Poashtu duke u bazuar në planet për zgjerimit të zonës së shërbimit, planifikimit për ndërtimin e Impjantit për trajtimin e ujrave të zeza, akreditimit të laboratorit të ri, kompania parasheh të punësojë një numër të punonjësve të ri gjatë periudhës 2023-2025:

- një (1) zyrtar çertifikues
- një (1) zyrtar për mjete themelore
- një (1) zyrtar ligjor
- një (1) teknik i elektros
- një (1) zyrtar për mbrojtje dhe siguri në punë
- një (1) zyrtar për teknologji informative (IT)
- një (1) laborant - e për analiza mikrobiologjike
- një (1) mostrues
- një (1) faturist - e
- një (1) mjeshtër ujësjellësi
- katër (4) punëtor fizik
- gjashtë (6) lexues
- një (1) punëtor - arhivist - e
- një (1) punëtor për mirëmbajtje të kanalizimit - Kamenicë
- dy (2) punëtorë të mirëmbajtjes – Kamenicë dhe Viti me orar të reduktuar

Koha e rekrutimit të këtyre punëtorëve do të varet nga progresi i punëve që do arrihen, gjatë vitit 2023 është planifikuar një Zyrtar çertifikues pasi që është kërkuar nga auditorët edhe gjatë vitit 2020 /2021 ka qenë e paraparë dhe kërkesë nga Departamenti i Financave pasi që është e domodoshme në mënyrë që mund të ushtroj kontrolle të brendshme financiare e sidomos zyrtarin çertifikues për pagesa, një zyrtar ligjor pasi që vëllimi i punëve është rritur, një teknik i elektros pasi që zona e shërbimit me pompime është në rritje të vazhdueshme, një faturist, një mjeshtër, dhe gjithëashtu rritja e punëtorëve për katër punëtor fizik. Është planifikuar të bëhet për shkak të rritjes së zonës së shërbimit dhe rritjes së aktiviteteve që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

KRU "Hidromorava" Sh.A, ka përgatitur skemën funksionale- ORGANOGRAMIN i cili përputhet me strategjinë zhvillimore sepse rolet dhe përgjegjësit janë të specifikuara mirë. Struktura e përgatitur do të prodhojë efikasitet në perspektivën e menaxhimit të kompanisë ashtu siç është paraqitur në skemën organizative të paraqitur më poshtë:

Struktura organizative aktuale deri në përfundim të ri organizimit është si në vazhdim



Gjithsej punetore  
167

## 6. Prodhimi i ujit për vitin 2023

Në raportet për prodhimin e ujit në pikat që menaxhohen nga KRU Hidromorava si dhe duke marrë parasysh mesataren e prodhimit për nëntë muajt e parë të vitit 2022 KRU Hidromorava ka planifikuar të prodhoj ujë për vitin 2023 afër 7,855,000 me<sup>3</sup> apo me një mesatare prej 654,000 m<sup>3</sup> në muaj.

Grafikoni



### 6.1 Kualiteti i ujit të pijshem në kuadër të Zonës së Shërbimit- Mumini

Kualiteti i ujit të pijshëm i shpërndarë në tërë zonën e shërbimit monitorohet rregullisht nga ekipet e specializuara të KRU Hidromorava në Gjilan por edhe nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Ndërtimi i laboratorit kryesor ka mundësuar një kontroll më efikase të ujit të prodhuar për konsumatorët brenda zonës së shërbimit. Duke marrë parasyshë se ne Implantet të trajtimit të ujit ne Përlepnice, Velekincë dhe Letnicë janë të vendosura paisjet për monitorim online të parametrave primar për cilësi të ujit, Kompania brenda vitit duhet të investojë në rehabilitimin e tyre pasi që disa nuk janë funksional dhe disa të tjera duhen të kalibrohen.

Gjatë viteve 2023-2025 Kompania planifikon të përmirësojë edhe më shumë cilësinë e ujit të pijshëm për të arritur shkallën deri në 100% të përmbushjes së standardeve të përcaktuara nga Instituti Kombëtarë i Shëndetësisë Publike në Kosovë

## 6.2.Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit


Krahas aktiviteteve të tjera, Kompania kujdeset për largimin e ujërave të ndotura të qyteteve të Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës përmes rrjetit shperndarës dhe kolektorëve kryesor por pa ndonjë trajtim para shkarkimit. Ujërat e ndotura të qytetit të Gjilanit shkarkohen përmes dy kolektorëve kryesor në lumin Morava, ato të qytetit të Vitisë përmes kolektorit kryesor shkarkohen në lumin Morava, ndërsa ato të qytetit të Kamenicës përmes kolektorit shkarkohen në lumin Krivareka.

Kompania për të ardhmen do ti kushtojë shumë rëndësi sektorit të kanalizimit si në investime po ashtu edhe në organizim në mënyrë që ky sektor të jetë shumë më efikas se deri me tani. Punët që priten të kryen nga këto ekipe janë:

- a) Inspektimi i pusetave të kanalizimit
- b) Riparimi i pusetave të kanalizimit
- c) Debllokimi dhe pastrimi

## Sistemi I furnizimit me uje te Gjilanit

### Skema hidraulike



## 5. SHËRBIMET PËR KONSUMATORË

Gjatë vitit 2022 numri i konsumatorëve të regjistruar deri në shtator të këtij viti është 39,156 , është rritur për 870 ,ndërsa është paraparë si rezultat i shtrirjes së zonës së shërbimeve deri në fund të këtij viti të arrihet 39,500 . Gjatë periudhë planifikuese 2023-2025 është paraparë të shtohen 1,400 kyçe të reja prej tyre 1,17 konsumatorë shtëpiak dhe 100 konsumatorë kategori komerciale. Në vitin 2023 identifikimi i konsumatorëve ilegal ka me qene më i lehtë si rezultat i përdorimit të sistemit GIS-it në funksion të plotë, ku me ndihmën e lexuesve dhe punëtorëve tjerë nga terreni do të identifikohen të gjithë ata të cilët e përdorin ujin e pijshëm të ujësjellësit në mënyrë të pa autorizuar-ilegale, dhe ata të cilët nuk janë të kyqur sipas pronave në ujësjelles dhe identifikimi i konsumatorëve me konsum zero.

Faturat do t'i lëshohen të gjithë konsumatorëve të regjistruar, çdo muaj, duke u bazuar kryesisht në konsumin e lexuar. Gjatë periudhës 2023-2025 pritet të ngritet norma e faturimit e bazuar në lexim të ujëmatësve deri në 100 %. Këtu do të përfshihet edhe pastrimi i bazës së të dhënave për të larguar konsumatorët jo-ekzistent dhe për të aktivizuar ata pasiv.

Në këtë vit do të vazhdojmë aktivitetin e përditësimit të kontratave me konsumatorë , kemi mundësuar shkarkimin e kontratës ëeb faqen tonë në mënyrë që të kursejmë kohën dhe të mbulojmë në një periudhë me të afërt gjithë këtë proces.

Kompania në vitin 2023 do të përdor metoda të ndryshme për rritjen e vlerës së arkëtimit, presion të vazhdueshëm ndaj konsumatorëve me borxhe , vazhdimin e angazhimit të përmbaruesit privat , mudesinë e riprogramimit të borxheve me qëllim të futjes në sistem pagese dhe parandalimit të parashkrimit të detyrimeve për të gjithë konsumatorët me obligime , shkyqjen e konsumatorëve të cilët nuk ju kanë përmbajtur detyrimeve për uje si dhe marrëvshjes në bazë kontratës .

Shkyqjet do të asistohen sipas rregullores së ARRU-së Nr.03/2017 për Procedurat e Ndërprerjes së Shërbimeve të ujit edhe nga Policia e Kosovës-Gjilan me të cilën do të arrijmë marrëveshje me shkrim për të na mbeshtetur në rastet kur na paraqitet nevoja . Gjithëashtu edhe konsumatorët të cilët nuk lejojnë shkyqjen teknike ne do ti procedojmë përmes gjykatës kompetente në Gjilan .

Kompania është përfundimisht e orientuar në plotësimin dhe kënaqjen e kërkesave të konsumatorëve të saj, përkundër natyrës monopolistike të biznesit të saj, si dhe sigurimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjithë akterët e sektorit të ujit në Kosovë dhe më gjerë. Shërbimi i mardhënieve me konsumatorë edhe më tutje do të përmirësohet për të përfshirë regjistrimin dhe raportimin elektronik, si dhe pranimin dhe shqyrtimin më efikas dhe brenda standardeve kohore, të ankesave të konsumatorëve.

### 6. Të ardhurat nga arkëtimi dhe shpenzimet operative

Arkëtimi i ujit në vitin 2023 planifikohet të jetë 2,388 mijë € apo 93.20% në raport të ujit të faturuar , pritet të kemi më tepër të hyra edhe nga borxhet e vjetra.

Në rritjen e inkasimit do të ndikojë dhe leximi më i shpeshtë dhe më i saktë i ujëmatësve, ku konsumatorët do të kenë fatura sipas harxhimit mujor gjatë leximit identifikohen dhe lidhjet e dyfishta ku pastaj ekipet të njëjtat i eliminojnë-shkyqin, por nëse konstatohet manipulimi me ujëmatës konsumatorët do të paditen në gjykatë dhe të përgjigjen sipas kodit penal.

Në ngritjen e inkasimit do të ndikoj dhe fuqizimi i ekipeve të shkyqjes duke ju bërë presion konsumatorëve borxhli.

Po ashtu në rritjen e inkasimit do të ndikoj forma e pagesave në arkat e kompanisë të cilat janë të shpërndara në pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe pagesat për mes llogarive bankare.

|                      |               | 2022 | 2023 | 2024 |
|----------------------|---------------|------|------|------|
| Shtëpiak             | % e arketimit | 92%  | 92%  | 92%  |
| Komercial-industrial | % e arketimit | 100% | 100% | 100% |
| Institucional        | % e arketimit | 100% | 100% | 100% |


Shpenzimet sipas kategorive për vitet 2022,2023 dhe 2024

'000

Tabela 7

| Emërtimi i shpenzimit                                 | 2022             | 2023             | 2024             |
|-------------------------------------------------------|------------------|------------------|------------------|
| Ngarkesa për shërbime ndaj ARRU, MMPH, SHUKOS         | 41,765           | 41,826           | 41,981           |
| Shpenzimet e materialit dhe materieve të konsumueshme | 54,211           | 54,382           | 54,561           |
| Shpenzimet e shërbimeve të kontraktuara               | 42,777           | 42,582           | 42,931           |
| Shpenzimet e energjisë                                | 243,518          | 243,530          | 243,544          |
| Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit               | 110,027          | 110,484          | 110,965          |
| Shpenzimet e derivateve                               | 31,242           | 31,484           | 31,738           |
| Shpenzimet e pagave                                   | 1,305,892        | 1,311,149        | 1,316,687        |
| Shpenzimet tjera direkte dhe indirekte                | 36,388           | 36,477           | 36,571           |
| <b>Total</b>                                          | <b>1,865,820</b> | <b>1,871,914</b> | <b>1,878,978</b> |

Grafiku 1



Nga grafiku e lart shënuar shohim rritje të shpenzimeve në çdo vit, kjo na bën të kuptojmë se çdo vit kemi rritje të zonës së shërbimeve dhe marrja e shume zonave rurale ne menaxhim si rrjedhojë e vazhdimit të projekteve nga donatorët dhe Komuna e Gjilanit , prandaj rezultojnë me rritje të shpenzimeve operative e sidomos shpenzimet që ndikojnë drejtpërsëdrejti në koston e prodhimit dhe distribuimit të cilat shumica janë me pompime dhe kanë kosto të lartë edhe për nga mrëmbajtja e tyre dhe në gjitha shpenzimet tjera në tërësi .

## 8. PLANI I SHERBIMIT TË SHITJES

### 8.1 Politikat dhe programet e Matjes

Në vitin 2023 planifikohet arritje e caqeve të arkëtimit nga shitja e ujit dhe shërbimeve të tjera duke aplikuar të gjitha masat me qëllim aritjen e cakut të planifikuar. duke shkyçje individuale sipas rasteve dhe shkyçje kolektive, sipas nevojës edhe me asistimin e Policisë së Kosovës, gjithnjë duke e respektuar Rregulloren Nr. 06/2016 për Ndërprerjen nga Shërbimet e Ujit në Kosovë . Konsumatorët të cilët largojnë pllombat do ti padisim në gjykatë për dëmtim të pllombës-ujëmatësit dhe të njëjtit do të ndëshkohen konform kodit penal të Kosovës.

Në vitin 2023 do ta mundohemi të zgjerojmë rrjetin e sistemit të pagesave si nga ana e arkave tona ashtu edhe me insitucionet mikro- financiare dhe do të eliminojmë pagesat në dorë nga inkasantet vetëm nga zonat urbane .

### 8.2 Evitimi i lidhjeve ilegale/fiktive/pasive

Identifikimi i lidhjeve ilegale do të bëhet në bazë të informatave që i sjellin (sigurojnë) punëtorët-lexuesit tanë nga tereni përmes aplikimit të detektorëve për dedektimin e lidhjeve të pautorizuara, por edhe me vet lajmërimin nga konsumatorët që deri më tani ishin ilegal.

Për identifikimin e konsumatorëve ilegal në vitin 2023 do të na shërbej shumë sistemi i GIS-it, për mes të cilit do të bëhet identifikimi më i lehtë i konsumatorëve ilegal pasi që shihet qartë secila pjesë që ka ta shtrire rrjet dhe identifikohet nëse ndonjë shtëpi është e kyqur në rrjet dhe nuk figuron në sistem

tek ne. Lexuesit dhe inkasantët i kanë të përshkruara në detyrat e punës për zbulimin e lidhjeve ilegale, aktivizimin e lidhjeve pasive, në të kundërtën do të japin përgjegjësi për mos kryerje të punëve.

### 8.3 Përditësimi i bazës së konsumatorëve

Faturimi i konsumatorëve bëhet duke u bazuar në leximin e ujmëmatësve, por aty ku nuk ka fare mundësi vendosja e ujmëmatësve sidomos tek banesat kolektive shume të vjetra për shkak të vjetërsisë së gypave faturimi bëhet në bazë të paushallit sipas udhëzimit të ARRU-se, varësisht se cilës kategori i takon konsumatori. Tarifat fikse (konsumatorë me konsum zero) gjithëashtu janë një indikator që duhet kushtuar rëndësi që rrjedhin si pasojë e shumë shkaqeve për të cilën do të kemi plane veprimi për ti zvogëluar në masë të dukshme.

